



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 717, datë 06.12.2023

PËR

**CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR VIJIMIN E SHQYRTIMIT TË
PROCEDIMIT DISIPLINOR, TË FILLUAR NDAJ MAGJISTRATIT Z. {...} ME
FUNKSION GJYQATAR PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 138 e vijues të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenet 16, 31, pika 1 dhe 2 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes, relacionin e përgatitur, pas shortit të hedhur

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, Z. Ilir Rusi, në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Caktimin e datës 07.12.2023, ora 11.00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit, z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR